

VENDIM
Nr.128, datë 14.11.2008

**PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “E-VENTO SRL ALBANIA”, PËR NDRYSHIMIN E
AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT (ZOTËRON PAKETËN
KONTROLLUESE)**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 12.5 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “E-VENTO s.r.l. Albania” sh.p.k., për marrjen e autorizimit për shtimin e aksionarëve të shoqërisë, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

dhe konstatoi se:

1. Shoqëria “E-VENTO s.r.l. Albania” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.84, datë 17.7.2008.

2. Propozimi për rishpërndarjen dhe shtimin e aksionarëve të “E-VENTO s.r.l. Albania” sh.p.k., shkakton ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat (zotëron paketën kontrolluese).

3. Ndryshimi i aksionarit që kontrollon interesat (zotëron paketën kontrolluese) sipas shoqërisë i shërben shtimit të kapacitetit teknik të kompanisë dhe uljes në mënyrë të ndjeshme të nivelit të kreditimit nga bankat për realizimin e investimit, pasi financimi i projektit do të bëhet me burime të brendshme.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të autorizojë shoqërinë “E-VENTO s.r.l. Albania”, për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat (zotëron paketën kontrolluese).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta